

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë :

Ardian Dvorani	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar

Në datën 11.04.2017 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen që ju përket palëve:

PADITËS: BUJAR DHIMA
E PADITUR: AUTORITETI PORTUAL DURRËS
OBJEKTI: Detyrimi e të paditur Autoriteti Portual Durrës të më dëmshpërblej me: 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës; 3x15 ditë shpërblim për vjetërsi në punë; 2 paga shpërblim për mosrespektim të procedurës për shkarkim nga puna; 2 paga për mosrespektim të afatit të njoftimit; Shpërblimin e një page.
Baza Ligjore: Neni 143, 144, 145, 153, 155 të K.Punës, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.19 datë 15.11.2007

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2091 (11-2013-4038), datë 30.07.2013 ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë.
2. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Portual Durrës të dëmshpërblejë paditësin Bujar Dhima në masën e 12 pagave mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, duke u përlloritur ky detyrim mbi bazën e pagës mujore prej 161.000 (një qind e gjashtëdhjetë e një mijë) Lekë.
3. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Portual Durrës të dëmshpërblejë paditësin Bujar Dhima në masën e pagës së 3 (tre) 15 ditëshave për vjetërsinë në punë, duke u përlloritur ky detyrim mbi bazën e pagës mujore prej 161.000 (një qind e gjashtëdhjetë e një mijë) Lekë.
4. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Portual Durrës të dëmshpërblejë paditësin Bujar Dhima në masën e 2 (dy) pagave mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke u përlloritur ky detyrim mbi bazën e pagës mujore prej 161.000 (një qind e gjashtëdhjetë e një mijë) Lekë.
5. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Portual Durrës të dëmshpërblejë paditësin Bujar Dhima në masën e 2 pagave mujore për mosrespektim të procedurës së pushimit nga puna, duke u përlloritur ky detyrim mbi bazën e pagës mujore prej 161.000 (një qind e gjashtëdhjetë e një mijë) Lekë.
6. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Portual Durrës t'i paguajë paditësit Bujar Dhima shumën prej 80.500 (tetëdhjetë mijë e pesë qind) Lekë si shpërblim për punën e kryer deri në datën 20.06.2013.
7. Rrëzimin e kërkesë-padisë për pjesën tjetër të saj.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.105, datë 28.01.2014 ka vendosur: Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për gjykimin e çështjes. Dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Apelit, si gjykatë kompetente.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1063, datë 26.03.2014 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.2091 (11-2013-4038), datë 30.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr.1063 datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me tjetër trupë gjykuese.

Tiranë, më 11.04.2017
Nr. 31003-02466-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00 - 2017 - 489 i Vendimit (239)